

KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH

Në Tiranë, më datën 10.02.2022 (dymijë e njëzetë e dy) lidhet kjo Kontratë midis palëve për shitblerjen e kuotave të kapitalit të shoqërisë:

SHITËSIT:

- **z. Taned Bllako**, i biri i Edmondit i datëlindjes 23.03.1993, lindur në Gjenovë dhe banues në Tiranë, identifikuar me anë të Letërnjoftimit me nr. personal J 30823062 C,
- **z. Edmond Bllako**, i biri i Arqilesë, i datëlindjes 04.04.1960, lindur në Përmet dhe banues në Tiranë, identifikuar me anë të Letërnjoftimit me nr. personal G 00404141 L,

të dy në cilësinë e ortakut të shoqërisë "**Alned 91**" Sh.p.k., regjistruar si person juridik në datën 22.12.2017, me NUIS: L87509001J;

BLERËSI:

z. Orest Sota, i biri i Lefterit, i datëlindjes 04.01.1992, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, identifikuar me anë të Letërnjoftimit me nr. personal J 20104040 Q;

NENI 1

- Secili nga shitësit është ortak me 50% të kuotave të shoqërisë "**Alned 91**" Sh.p.k., regjistruar si person juridik në datën 09.01.2018, me NUIS: L87509001J; , me seli në, Rruga "Ropi Stillo Gostivishti", Fabrika e Birrës "**ALNED 91**", Kati 2, Ersekë.

1.1 Këto kuota të shoqërisë Shitësit ia shesin Blerësit i cili pranon t'i blejë ato sipas kushteve dhe në masën e përcaktuar më poshtë në këtë kontratë.

NENI 2

2.1 Çmimi i shitjes së kuotave në pronësi të Shitësve, të cilët përfaqësojnë 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë "**Alned 91**" Sh.p.k., është në vlerën 100 Lek.


NENI 3

3.1 Blerësi i blen kuotat që shet Shitësi, si më poshtë:

Orest Sota, blen 50% të kuotave, të shoqërisë "**Alned 91**" që zotërohen nga **z. Taned Bllako** kundrejt vlerës 50 (pesëqind) Lekë. Blen 50% të kuotave, të shoqërisë "**Alned 91**" që zotërohen nga **z. Edmond Bllako** kundrejt vlerës 50 (pesëqind) Lekë.

Në këtë mënyrë blerësi bëhet ortak me 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "**Alned 91**" Sh.p.k.

3.2 Palët deklarojnë se çmimi i shitjes së këtyre kuotave është shlyer plotësisht nga Blerësi dhe palët nuk kanë asnjë pretendim për këtë fakt.



3.3 Me shitjen e këtyre kuotave, përbërja e ortakëve në shoqërinë "Alned 91" Sh.p.k. ndryshon dhe bëhet si më poshtë:

Orest Sota zotëron 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

3.4 Me realizimin e kësaj shitblerje të 100% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë "Alned 91" Sh.p.k., Blerësit i transferohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga blerja.

NENI 4

4.1 Shitësit deklarojnë se janë pronarë me të drejta të plota mbi kuotën që i transferojnë Blerësit; nuk kanë lidhur asnjë kontratë dhe asnjë lloj marrëveshje mbi pronësinë e saj apo që t'i kenë njohur të tretëve të drejta të çfarëdo lloji mbi të deri në datën e sotme; ata e shesin këtë kuotë të kapitalit të shoqërisë Blerësit të lirë nga çdo detyrim, barrë apo pretendim nga të tretë; të drejtat mbi të nuk janë të përfshira në procese civile, penale, administrative, arbitrazhi apo të çfarëdo lloji natyre tjetër që të mund të jetë shkak për cënimin e kontratës apo titullin e pronësisë së Blerësit mbi kuotën.

NENI 5

5.1 Palët deklarojnë se do të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo kontratë.

5.2 Në rast mosmarrëveshje midis tyre në zbatim të kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Në rast se nuk do të arrijnë në zgjidhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë hartohet në 3 (tre) ekzemplarë me të njëjtën vlerë ligjore dhe palët pasi e lexuan dhe e gjetën në përputhje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë e nënshkruajnë pa vërejtje.

PALET KONTRAKTORE

SHITËSI

Taned BLLAKO *TANED BLLAKO*

Edmond BLLAKO *Edmond Bllako*

BLERËSI

Orest SOTA

Orest Sota

[Handwritten signatures and stamps]



Jep miratimin bashkëshortja e shitësit
